

Preportr

SHUMË TENDERË PAK KONTROLL

Korporata Energjetike e Kosovës, ndërmarrja me më së shumti shpenzime të parasë publike përmes tenderëve, vazhdon të mos auditohet nga ZKA-ja. Hulumtimi i Preportr dëshmon se shumë kompani të cilat janë penalizuar ndër vite për mosrespektim të kontratës vazhdojnë të fitojnë miliona euro përmes tenderëve. KEK-u është institucioni publik ndaj të cilit parashtrohen më së shumti ankesa nga operatorët ekonomikë lidhur me shkeljen e Ligjit të Prokurimit. Në anën tjetër, vetë kjo ndërmarrje disa herë nuk i ka respektuar vendimet e OSHP-së.

SHUMË TENDERË. PAK KONTROLL

Leonida Molliqaj & Qëndrim Bunjaku

Korporata Energjetike e Kosovës, ndërmarrja me më së shumti shpenzime të parasë publike përmes tenderëve, vazhdon të mos auditohet nga ZKA-ja. Hulumtimi i Preportr dëshmon se shumë kompani të cilat janë penalizuar ndër vite për mosrespektim të kontratës vazhdojnë të fitojnë miliona euro përmes tenderëve. KEK-u është institucioni publik ndaj të cilit parashtrohen më së shumti ankesa nga operatorët ekonomikë lidhur me shkeljen e Ligjit të Prokurimit. Në anën tjetër, vetë kjo ndërmarrje disa herë nuk i ka respektuar vendimet e OSHP-së.

KOMPANITË QË FITUAN MË SË SHUMTI NGA TENDERËT NË KEK

Eco Trade

91,638,314.00

Takraf

45,866,068.00

ThyssenKrupp
Fordertechnik
GmbH

54,867,707.00

Intering

34,394,724.00

IMK 14 Oktobar

49,983,528.00

ACDC - Kos

33,617,856.00

Intering GmbH

48,054,385.00

Hamon
Environmental
GmbH

25,897,000.00

Ex fis

46,534,571.00

Alstom Power
Service

24,776,682.00

*Disa nga këto kompani, disa nga tenderët i kanë fituar në konzorcium me njëra tjetrën.

Korporata Energjetike e Kosovës (KEK) është ndër ndërmarrjet publike më të madha në Republikën e Kosovës. Si një institucion me rëndësi të veçantë ajo shpesh ka qenë në fokusin e mediave dhe të shoqërisë civile për keqpërdorim e keqmenaxhim të buxhetit të shtetit përmes tenderëve publikë.

KEK-u është institucioni me pjesëmarrjen më të madhe në prokurim publik në Kosovë. Përmes tenderëve kjo ndërmarrje shpenzon miliona euro brenda një viti. Hulumtimi i Preportr tregon se vetëm gjatë viteve 2007-2017 KEK-u ka pasur mbi 10 mijë aktivitete të

prokurimit publik me vlerë mbi 1.3 miliardë euro.

Në kuadër të këtij hulumtimi, Preportr ka shqyrtuar kontratat me vlerë të madhe në KEK gjatë viteve 2007-2017. Gjatë kësaj periudhe KEK-u ka dhënë 955 tenderë në vlerë rreth 752 milionë euro. Përfutues të këtyre tenderëve janë rreth 300 kompani vendore e ndërkombëtare. Vetëm dhjetë prej tyre kanë fituar rreth 380 milionë euro gjatë dhjetë viteve të fundit.

Shumë prej kompanive që fitojnë tenderë në këtë ndërmarrje janë treguar të papërgjegjshme dhe nuk e kanë kryer punën e tyre sipas kontratës. Lidhur me këto shkelje KEK-u ka penalizuar ndër vite kompani të ndryshme.

Preportr ka gjetur se të njëjtat kompani që janë penalizuar me dhjetëra herë për papërgjegjshmëri, kanë përfituar përsëri tenderë në KEK.

Numri i madh i kontratave publike si dhe natyra e komplikuar e tyre e ka bërë edhe më të vështirë kontrollin e parasë publike dhe procedurave të prokurimit në KEK. Njohësit e fushës së prokurimit në Kosovë vlerësojnë se ekziston nevoja për një kontroll më sistematik të kësaj ndërmarrjeje.

Shumë ankesa ndaj KEK-ut dorëzohen nga Operatorët Ekonomikë (OE) në Organin Shqyrtues të Prokurimit Publik (OSHP) me pretendimin që procedurat prokuruese kanë

qenë të ndikuara apo në shpërputhje me ligjin që e rregullon prokurimin publik.

Në anën tjetër KEK-u pavarësisht se është i obliguar t'i respektojë vendimet e OSHP-së, në disa raste nuk i është bindur këtij institucioni.

Edhe pse kjo ndërmarrje është shpenzuesi më i madh në Kosovë përmes prokurimit publik, me 33% pjesëmarrje në raport me ndërmarrjet dhe organizatat tjera, ajo nuk auditohet nga Zyra Kombëtare e Auditorit (ZKA). Ky fakt është shqetësues dhe hap rrugën për keqpërdorime të mundshme, vlerësojnë përfaqësuesit e organizatave joqeveritare që përcjellin prokurimin publik.

KOMPANI TË PAPËRGJEGJSHME. FITOJNË MILIONA EURO

Shumë kompani që përfitojnë tenderë në Korporatën Energjetike të Kosovës kanë shkelur kontratat publike për vite me radhë. Preportr ka gjetur listën e penalizimeve që kjo ndërmarrje ka bërë ndaj kompanive të ndryshme të cilat nuk i kanë kryer obligimet ndaj autoritetit kontraktues. Sipas këtij hulumtimi, gjatë viteve 2010-2017

KEK-u ka penalizuar 163 kompani për moszbatim të kontratave në 707 raste në vlerë prej 1.7 milionë euro. Shumë nga kompanitë janë penalizuar disa herë gjatë vitit. Ka raste kur një kompani është penalizuar 61 herë brenda një viti. Pavarësisht që kompanitë në fjalë nuk kanë i kanë kryer punët sipas marrëveshjes me

shkrim, ato kanë vazhduar të shpërblehen në vitet pasuese nga KEK-u. Preport ka krahasuar listën e kompanive të penalizuara nga KEK-u me listën e përfituesve në këtë institucion dhe ka gjetur se 60 nga 163 kompanitë e penalizuara kanë fituar 642 tenderë vetëm me vlerë të madhe gjatë viteve 2008-2017, në vlerë mbi 368 milionë euro.

Nga kompanitë e penalizuara janë edhe tri kompani të cilat janë në top dhjetëshen e tenderëve të fituar në KEK. Pavarësisht që bizneset si “Eco trade”, “Ex fis” dhe “Intering” nuk u treguan të përgjegjshme në zbatim të kontratave, ato vazhduan të fitojnë miliona euro.

Penalltitë

Emri biznesit	Nr i rasteve	Vlera totale e penalltive
Adria - 7	2	1,038.55
Alkom	1	599.89
ATM-PR	3	2,132.12
B&L	2	1,120.71
Blue trade	10	10,348.59
Dona Impex	13	5,808.07
E-projekt	3	1,962.48
Elektro DT projekt	1	264.48
Euro Comerc	14	6,891.69
Euro Energji	2	777.20
Euro Impex	3	801.20
Euro Trade	1	3,233.27
Feki	1	289.91
G3 Inxhiniering	9	13,555.86
Gramozi	2	2,342.53
I&A	1	3,276.25
KWE	5	35,229.60
Mont Commerce	8	6,029.95
Mont Ennigiering	10	3,602.83
Nilos	7	6,221.46
Toni	8	1,884.02
Solar	5	2,212.28
PBC Kosova	5	8,666.38
Profitech	5	2,770.32
Rima	1	2,313.67
Rima Ennginiering	18	49,544.55
Ripten Ennginiering	8	34,272.95
Simenc	1	6,024.00
Solid Company	6	22,188.96
Union	13	8,111.72
Xani - NEX	27	31,542.50
ADE	5	4,172.60
Aerocom	9	107.43
Ar tech	3	9,294.37
ARB Com	6	9,143.78
Audit Group	7	4,155.22
B&D Ennginiring	7	7,173.52
Balkan Petrol	19	39,089.57
Blendi	7	54.03
City Comptuter	4	2,320.94
Elektro AG	5	27,553.90
EX FIS	4	2,467.96
GHM Company	20	6,857.30
H&S com	1	4,130.08
Hekurani	7	31,221.96
Info Soft Office	14	887.85
I-Pharma	2	422.27
Kombinimi	23	3,550.03
Kromos	7	1,194.71
Turbocare	1	685,868.37
AGS	1	246.07
Bojku Hidraulik	5	1,573.14

Tenderët e fituar në KEK (vlera e madhe)

Emri biznesit	Nr i tenderëve	Vlera e tenderëve
	2	775.00
	1	401,822.00
	14	1,234,288.00
	8	1,272,594.00
	4	822,780.00
	24	1,813,454.00
	12	3,862,679.00
	22	8,484,175.00
	15	1,451,622.00
	5	1,450,330.00
	4	541,649.00
	3	173,276.00
	2	242,304.00
	27	7,952,135.00
	2	467,884.00
	7	4,133,445.00
	4	628,794.00
	7	6,654,629.00
	10	1,212,651.00
	15	3,507,478.00
	5	946,110.00
	9	3,407,372.00
	5	2,649,331.00
	4	698,551.00
	3	39,727.00
	24	4,270,456.00
	26	7,063,934.00
	2	3,248,125.00
	15	7,660,912.00
	11	715,924.00
	32	11,039,738.00
	5	151,530.00
	2	11,371.00
	1	227,717.00
	1	165,748.00
	10	667,428.00
	13	2,369,381.00
	18	9,970,928.00
	2	93,178.00
	3	535,616.00
	3	128,192.00
	6	46,534,571.00
	7	1,098,828.00
	8	1,045,691.00
	24	3,373,966.00
	1	37,593.00
	1	27,561.00
	3	2,580,705.00
	3	929,439.00
	6	13,876,047.00
	2	999,239.00
	8	2,482,568.00

Penalltitë

Emri biznesit	Nr i rasteve	Vlera totale e penalltive
Diari	1	37.87
Eco trade	6	15,628.74
Edi	1	80.00
Eldi com	1	1,819.60
Era Med	7	768.41
Euro Energji	6	1,090.28
Eurogoma	7	3,158.78
Exim com	4	1,601.35
PLUS	1	169.57
Inline Engeenering	3	225.24
Intering	1	1,419.96
Mont elektro	1	658.44
Ora Engeenering	2	834.51
Ortu	4	704.27
Sadiku A	1	110.63
Sankos	6	1,868.09
Atlas	3	182.31
Auto Kosova	6	2,326.11
Beni Construction	1	4,795.74
Euro Printy	3	276.71
Feroda Commerce	4	3,439.58
Monting Energjetika	3	7,798.99
ND	1	796.52
Pashtriku	1	7.38
Beli Com	62	9,254.81
Botek	4	605.45
Cactus	2	590.92
Elico	2	731.00
Elsam	7	7,923.00
Elting	2	3,518.00
HB Project	3	10,965.00
NAT NTSH	4	496.60
Newko Ballkan	6	26,430.00
Rexha	1	4,178.97
Bagdat	1	2,675.00
CMC Ekokon	1	58.19
Ekoinvest	4	23,572.19
Graniti	1	10.92
Info Com	7	1,187.88
Luca Bau	1	25.56
Metal Projekt	5	424.00
Monten	1	232.76
Office 1 Kosova	19	708.66
Rudnap Group	12	360,000.00
SNR Group Kosova	9	750.60
Tehnoburimi	1	177.16
Ukab	4	3,405.00
Arta Tex	1	147.42
Electra	1	369.12
Energoremont Holding AD	2	4,912.11
Bussines Pro	1	373.15

Tenderët e fituar në KEK (vlera e madhe)

Emri biznesit	Nr i tenderëve	Vlera e tenderëve
	1	1,357,448.00
	20	91,638,414.00
	1	çmimi për njësi
	1	174,999.00
	2	90,392.00
	5	1,450,330.00
	2	188,297.00
	1	94,517.00
	3	182,397.00
	2	597,783.00
	11	34,694,724.00
	3	464,451.00
	3	416,022.00
	20	7,077,936.00
	5	242,427.00
	7	1,158,586.00
	1	112,595.00
	6	493,938.00
	1	600,000.00
	1	260,379.00
	12	375,152.00
	5	292,683.00
	1	106,202.00
	1	247.00
	2	765,000.00
	1	2,552,900.00
	1	320,485.00
	6	775,435.00
	7	1,517,146.00
	1	88,861.00
	1	395,094.00
	1	18,066.00
	10	5,681,596.00
	1	144,531.00
	2	374,572.00
	2	297,308.00
	5	5,254,510.00
	2	102,812.00
	1	715.00
	2	438,430.00
	1	383,055.00
	10	17,049,048.00
	1	174,402.00
	2	5,000,000.00
	4	149,695.00
	1	134,361.00
	8	8,432,447.00
	1	306,459.00
	1	188,685.00
	1	14,252.00
	1	82,445.00

Sipas Isak Kerollit, drejtor ekzekutiv në zyrën e prokurimit në KEK, procedurat e penalizimit janë të rregulluara me kontratë dhe në shumicën e rasteve autoriteti kontraktues më shumë preferon të penalizojë kompaninë në rastet e mosrespektimit të kontratës sesa t'i shkëpusë atë, me arsyetimin e dëmit buxhetor që mund të shkakttojë anulimi i një procedure të prokurimit.

“Dëmi nuk mund asnjëherë të kompensohet. Ne kemi raste ku gjendemi para vendimit se a duhet ta shkëputim një kontratë ku dëmi

do të ishte edhe më i madh, apo të panalizojmë”, ka thënë ai.

Kerolli thotë se KEK-u si autoritet kontraktues nuk mund t'ia ndalojë asnjë kompanie të ofertojë në aktivitetet të prokurimit, përderisa kompania nuk është në listën e zezë.

“Nuk mundet autoriteti kontraktues me e futë një kompani në listë të zezë por mund ta rekomandojë për listë të zezë. Ne si autoritet kontraktues kemi me dhjetëra rekomandime për lista të zeza. Derisa nuk është në listë të zezë sipas Ligjit të Prokurimit Publik, nuk mund t'ia


ndalojmë të ofertojë në aktivitetet e ardhshme”, ka thënë ai.


Për Diana Krasniqin nga Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) është jashtëzakonisht e rëndësishme që kompanitë të cilat janë treguar të papërgjegjshme në realizim të kontratave të ndëshkohen në procedurat e ardhshme të prokurimit. Sipas saj mungojnë dispozitat ligjore që kërkojnë që secila kontratë të vlerësohet gjatë performancës së kompanive.

“Fatkeqësisht në listën e zezë që e kemi në Kosovë, OE-të futen për shkelje penale psh.,

falsifikim dokumentash, mirëpo jo për shkelje të kontratës. Nëse një OE ka qenë i papërgjegjshëm apo penalizohet për mospërbushje të kushteve kontraktuale me të cilat është dakorduar fillimisht me nënshkrimin e kontratës, ishte dashur si pjesë e vlerësimit të kontratës të ekzistojë një kategorizim i vlerësimit të operatorëve ekonomikë ku këta OE do të sanksionoheshin për aplikim në procedura të Prokurimit Publik për një vit apo varësisht nga ndikimi që ka pasur mospërformanca e tyre në procedura publike”, ka thënë ajo.

KOMPANITË E PENALIZUARA NDËR VITE





SHUMË ANKESA PËR KEK-UN

Lidhur me procedurat e prokurimit publik janë ushtruar një numër i madh i ankesave ndaj KEK-ut nga operatorët ekonomikë në Organin Shqyrtues të Prokurimit Publik.

Sipas të dhënave që ka analizuar Preportr vetëm në periudhën 2008-2017, Operatorët Ekonomikë kanë ushtruar 381 ankesa në OSHP ndaj KEK-ut.

Nga këto ankesa afër 50% e tyre kanë shkuar në rivlerësim apo ritenderim.

Sipas Arbelina Dedushajt, monitoruese në OSHP nga Demokracia Plus, kryesisht operatorët ekonomikë ankohen për mosrespektim të Ligjit të Prokurimit Publik, dispozitat që kanë të bëjnë me diskriminimin e OE-ve, specifikacionin teknik dhe anulimin e padrejtë të tenderëve.

“Bazuar në monitorimin e vazhdueshëm të Organit Shqyrtues të Prokurimit, KEK mbetet

njëra ndër autoritetet kontraktuese ndaj të cilës ushtrohen më së shumti ankesa nga ana e OE”, thotë ajo.

Pavarësisht numrit të madh të ankesave, zyrtarët e KEK-ut mendojnë që ato janë në proporcion me numrin e procedurave të prokurimit që realizon kjo ndërmarrje.

“Duke pasur parasysh numrin e madh të aktiviteteve të prokurimit dhe kompleksitetin e lëndëve, sepse kemi të bëjmë me industri, konsideroj që numri i ankesave është një numër i mjaftueshëm”, ka thënë Isak Kerolli.

Një ndër kritikant kryesore që kanë monitoruesit e prokurimit ndaj KEK-ut është moszbatimi i vendimeve të OSHP-së.

“Problemi kryesor është pikërisht mosrespektimi i vendimeve të OSHP-së dhe kjo mund të bëjë që ankesat të përsëriten dhe tenderët të zvarriten, vonesa të cilat shpesh shkaktojnë

dëme milionëshe”, ka thënë Dedushaj.

Diana Krasniqi vlerëson se vendimet e OSHP-së janë vendime të obligueshme dhe të gjitha palët duhet t’i respektojnë. “Nëse OSHP thotë se duhet të kthehet në rivlerësim ajo duhet të kthehet, nuk është opinion, është vendim. Fatkeqësisht, për shkak se askush nuk penalizohet vendimet vazhdojnë me u anashkalu prej institucioneve si KEK-u në këtë rast”, ka thënë ajo.

Në anën tjetër zyrtarët e prokurimit në KEK nuk kanë pranuar se nuk kanë respektuar ndonjëherë vendimet e OSHP-së. “Konsideroj që KEK deri më tani ka respektuar të gjitha vendimet e OSHP-së sepse na pëlqeu ose jo OSHP-ja është organ suprem në aspektin e prokurimit edhe ne jemi të detyruar me i respektu vendimet”, ka thënë Isak Kerolli duke shtuar se në rastet kur KEK-u nuk pajtohet me


vendimet e OSHP-së, i zbaton ato mirëpo në të njëjtën kohë ndjek edhe rrugë ligjore për apelim në gjykata apo instanca të tjera.

Preportr ka gjetur se nga viti 2011 deri në vitin 2017 OSHP ka dhënë 10 urdhëresa për moszbatim të vendimeve të panelit shqyrtues nga ana e KEK-ut.

grafikon

“Ka raste të tilla, jo vetëm KEK-u por edhe institucione të tjera kur nuk i respektojnë vendimet e OSHP-së, në atë moment edhe ligji e parasheh që OSHP-ja mund të parashtrorë një urdhëresë për respektim të atij vendimi, faktikisht mund të lëshojë edhe një urdhëresë për gjëritje të autoritetit kontraktues”, ka thënë Agim Shaqiri nga Organi Shqyrtues i Prokurimit Publik.

NUMRI I ANKESAVE NË OSHP PËR KEK NDËR VITE



2013

2014

2015

2016

2017

72

37

56

106

98

62,002.25 €

12,197.98 €

748,136.17 €

61,574.39 €

81,834.07 €

NUMRI I VENDIMEVE PËR RIVLERËSIM DHE RI TENDERIM NGA OSHP

RIVLERËSIM

2

3

2

5

13

14

8

21

20

29

RI TENDERIM

2

11

7

3

2

3

10

10

5

3

2008

2009

2010

2011

2012

2013

2014

2015

2016

2017

URDHËRESAT NDËR VITE

URDHËRESAT E OSHP PËR MOS ZBATIM TË VENDORIT TË PANELIT SHQYRTUES



SHPENZIMET E KEK-UT NUK AUDITOHEHEN NGA ZKA

Pavarësisht që Korporata Energjetike e Kosovës është një ndër institucionet që shpenzon më së shumti para publike me anë të procedurave të prokurimit, kjo ndërmarrje nuk auditohet nga Zyra Kombëtare e Auditimit (ZKA).

Sipas Qëndresa Mulajt, zëdhënësese së kësaj zyre, arsyet pse nuk është audituar KEK gjatë kësaj kohe kanë qenë kryesisht mungesa e burimeve njerëzore. Megjithatë, ajo thekson se drejtori i kësaj zyre, Besnik Osmani, ka ndërmarrë masa dhe ka zhvilluar një plan të auditimit të ndërmarrjeve publike duke filluar në vitin 2016.

“Nuk mund të them saktësisht për auditimin e KEK-ut sepse ka faktorë që duhet analizuar dhe vlerësuar për të ardhur në përfundim nëse KEK-u do të jetë në listën e auditimeve në vitin e ardhshëm, megjithatë ZKA-ja ka një plan për tri vitet e ardhshme për auditimin e ndërmarrjeve publike dhe është duke punuar në këtë plan duke vlerësuar të gjitha rrethanat dhe faktorët që përcaktojnë ndërmarrjet që do të jenë në planin e auditimit”, ka thënë Mulaj.

Zyra e auditorit vlerëson se procesi i jashtëm i auditimit ka rezultuar pozitivisht në të gjitha organizatat buxhetore. “Pikërisht se e kemi pa që dy vitet e fundit ka rezultuar se auditimi i jashtëm si proces ka ndikim pozitiv dhe ndërmarrjet publike kanë shumë nevojë që të auditohen prej ZKA-së, ne vlerësojmë se kjo është e rëndësishme dhe do të ndikojë në përmirësimin e menaxhimit të brendshëm të ndërmarrjeve publike qoftë financiar apo kontrolleve të tjera të brendshme por edhe do të ndikojë që këto ndërmarrje të arrijnë të ofrojnë shërbime më të mira për qytetarë”, ka thënë Mulaj.

Diana Krasniqi nga KDI vlerëson se mungesa e auditimit të KEK-ut është një shqetësim i vazhdueshëm që si rrjedhojë ka pasur mungesën e kapaciteteve të auditorit. Sipas saj, pavarësisht mungesës së kapaciteteve të kësaj zyre, auditori është dashur të gjejë ndonjë mundësi për auditimin e ndërmarrjeve publike, duke ditur rëndësinë e tyre.

Pavarësisht që KEK-u nuk auditohet nga ZKA-ja, drejtori i prokurimit të kësaj ndërmarrjeje, Isak Kerolli, thotë se sipas ligjit KEK-u ka kontraktuar kompani të cilat kryejnë auditim të jashtëm. Sipas Kerollit, auditori kërkon nga KEK-u të ketë qasje në disa kontrata të prokurimit publik të cilat merren si mostër për auditim. Preportr ka shikuar të gjitha raportet e publikuara nga kjo ndërmarrje por në asnjërin prej tyre nuk ka gjetur ndonjë pjesë ku trajtohen gjetjet mbi kontratat e audituara.

KEK-u sikur edhe ndërmarrjet e tjera publike ka edhe zyrën e brendshme të auditimit, por raportet e tilla nuk janë publike dhe përdoren vetëm për nevojat e brendshme.

“KEK jo që nuk është i audituar po është është prej ndërmarrjeve më të audituara në Kosovë”, ka thënë Kerolli.

Por sipas Diana Krasniqit nga KDI, auditimi i jashtëm nga kompanitë e caktuara mund të mos jetë gjithmonë objektiv.

“Problemi me auditimin e jashtëm është se kur ndërmarrjet kontraktojnë një kompani të jashtme mundet me pasë edhe ndonjë ndikim të ai auditor se qysh i pasqyrojnë gjetjet apo raportet financiare apo të shpenzimeve të atij institucioni”.

Shënim: Ky publikim u financua nga Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur (KFOS). Mendimet, përfundimet dhe konkludimet apo rekomandimet e shprehura këtu janë të Autorit(ëve) dhe jo medoemos pasqyrojnë qëndrimet e Donatorit

Qendra Kosovare për Gazetari Hulumtuese mbështetet nga:



Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur
Kosovo Foundation for Open Society



CIVIL
RIGHTS
DEFENDERS



Sweden
Sverige



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Swiss Agency for Development
and Cooperation SDC

MINISTRY OF FOREIGN AFFAIRS OF DENMARK
DANIDA | INTERNATIONAL
DEVELOPMENT COOPERATION